



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E VUSHTRRIË

Rr. "Adem Jashari" nr.1, tel.028 571343

DATE/A:	30.10.2020
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Të gjithë të interesuarit për aplikim për "Furnizim me Makina Kositëse për Traktor"
NGA/OD/FROM:	Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural Z. Miran Halili
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Thirrje për Aplikim

Njoftohen të gjithë të interesuarit se mund të aplikojnë në thirrjen për përfitimin e Makinës kositëse për traktor.

Makinat kositëse për traktor-Kosa Roto 135, të tipit pijator (dy pjata)

I.Aplikuesi duhet t'i plotësojë kushtet e përgjithshme si në vijim:

1. Të jetë banorë i Komunës së Vushtrrisë;
2. Të jetë prodhues i qumështit dhe kulturave lavërtare;
3. Të posedoj traktorë adekuat për përdorim të kosës ROTO;
4. Përparësi kanë fermerët të cilët nuk kanë përfituar më herët;
5. Aplikuesi duhet të participoj në financimin e projektit nëse përzgjidhet si përfitues në vlerën prej 257,00€ .

II. Përzgjedhja e përfituesit do të bëhet duke u bazuar në kriteret e më poshtme:

1	Kategoritë e familjeve me jetim, familjeve të dëshmorëve, martirëve, invalidë dhe veteranë.	4 pikë				
2	Fleta poseduese në emër të aplikuesit	5 pikë				
3	Familjet me distancë të largët nga qendra e qytetit	4 pikë	1-7 km 1 pikë	8-10 km 2 pikë	11-15 km 3 pikë	Mbi 15 km 4 pikë
4	Familjet me numër më të madh të antarëve të papunë	4 pikë	1-2an. 1 pikë	3-4an. 2 pikë	5-6an. 3 pikë	Mbi 6 an. 4 pikë
5	Familjet me numër të madh fëmijësh	4 pikë	1-2fëm. 1 pikë	3-4fëm. 2 pikë	5-6fëm. 3 pikë	Mbi 6fëm. 4 pikë
6	Fermeri që posedon gjedhe qumështore	5 pikë	3-6 lopë 5pikë	7 -10lopë 4 pikë	11 -15lopë 3 pikë	Mbi 15 lopë 2 pikë
7	Fermeri që posedon sipërfaqe të mbjellura sipas aplikacionit në AZHB	10 pikë	3- 4ha 10 pikë	4-6ha 8 pikë	6- 8ha 6 pikë	Mbi 8ha 4 pikë
8	Fermeri që nuk ka qenë përfitues ose ka qenë përfitues sipas viteve	10pikë	Nën 2017 10pikë	Vitin 2017 4 pikë	Vitin 2018 3 pikë	Vitin 2019 2 pikë
9	Kualifikimi-	4 pikë	4 pikë	Fakulteti-drejtimi bujqësisë		
			2 pikë	Shkolla e mesme bujqësore		
10	Kapaciteti i aplikuesit për jetësimin e grantit (vlerësimi nga terreni)	5 pikë				
	Numri total i pikëve	55 pikë				

Gjatë procedurës së kontrollit, në rast të gjetjes së shkeljeve dhe tentimit për mashtrim do të aplikohen masa ndëshkimore duke mos i dhënë mundësi përfitimi për tre vitet e ardhshme.

Dokumentet për aplikim:

1. Aplikacioni i plotësuar;
2. Kopja e letërnjoftimit të aplikuesit;
3. Vërtetimin për kryerjen e obligimeve komunale(tatimi në pronë, mbeturinat-merret parasysh vetëm vërtetimi i aplikuesit dhe familjareve nga certifikata e bashkësisë familjare);
4. Certifikata pronësore (fleta poseduese)-kopje;
5. Certifikatën e bashkësisë familjare;
6. Vërtetimin e posedimit të lopëve qumështore-kopje;
7. Dëshminë për sipërfaqet e mbjella (formulari për aplikim-pagesa direkt);
8. Dëshminë për përgatitjen profesionale(nëse posedon)-kopje.

Aplikohet në zyrën pritëse të Komunës.Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit si dhe i pakompletuar nuk do merret në shqyrtim.

Afati i fundit për aplikim: 13.11/2020 ora 15:30.